

V E N D I M
Nr. 308, datë 27.6.2002

PËR RRITJEN E NIVELIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Niveli bazë i pagesës së papunësisë bëhet 3 600 lekë në muaj.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2002 për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko